



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 303/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi kryesues, Nenad Lazić dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) me seli Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, për shkak të premtimeve elektorale gjatë të mbajtjes së tubimit publike, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 25.10.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), me seli Prishtinë.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 22.10.2013, nga subjekti politik LDK, me seli në Prishtinë, me të cilën theksohet se Kryeministri i Republikës së Kosovës njëkosisht edhe kryetar i subjektit politik PDK, në tubimin elektorale në komunën Podujevë, me datën 21.10.2013, ka premtuar 100 milion euro investime në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Me këtë veprim parashtruesi i ankesës pretendon se është bërë shkelje e nenit 33 pika f lidhur me nenin 35 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), neni 3.4 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale në Kosovë, mëtej theksohet se është shkelur “Kodi i Mirësjelljes” si dhe nenin 3.6 të Rregullës Nr.01/2012 për “Kategorizimin e Sanksioneve dhe Gjobave” të PZAP-it.

Si provë ka bashkangjitur raportimin nga portali informativ “indeksonline”, kronika zgjedhore të transmetuara në Radio Televizionin e Kosovës (RTK), të datës 21.10.2013.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik PDK, me datën 24.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 25.10.2013. Sipas afatit të caktuar PZAP-i pranoi përgjigjen në ankesë, në të cilën theksohet se pretendimet e parashtruesit të ankesës janë të pabazuara. Mëtej në përgjigje të ankesës potencohet se është e drejtë e secilit lider partiak, pavarësisht pozitës aktuale politike a institucionale të shpalos programet dhe planet e tyre, për nivelin lokal., me propozim që ankesa të refuzohet si e pabazuar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi ankesën gjeti se:

ankesa është e pabazuar

PZAP-i, konstaton se pretendimet ankimore nga subjekti politik LDK, nuk qendrojnë nga shkakut se shkeljet e theksuara nuk konsiderohen veprime të ndaluara konform dispozitave ligjore të nenit 33 pika f dhe nenin 35 të LZP-së, ngase me këto nene parashihen shkeljet që kanë të bëjnë me shpërblime financiare me qëllim të përfitimit të votave, e që në rastin konkret premtimet e bëra ashtu siç janë theksuar në ankesë kanë të bëjnë me investime kapitale e të cilat nuk janë të ndaluara në dispozitat e sipërshtuar ligjore, andaj pretendimet e tilla u vlerësuan si të pabazuara dhe në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

Anr. 303/2013 më datën 25.10.2013.

Kryesuesi i Panelit

Nehat Idrizi

LDZP

Prishtinë / Pristina

Prishtinë / Pristina

Këshillë Juridike: PZAP-i nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.